

VENDIM
Nr.839, datë 6.12.2011

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES SË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 26.6.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, si autoritet kontraktor, për të përfunduar, brenda datës 20 dhjetor 2011, procedurat e prokurimit publik, me objekt “Hartimi i projektzbatimit për përshtatjen e godinës së ish-Institutit të Kërkimeve Zooteknike në godinë të Dhomës Administrative”. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha